


Hapësirat
Publike
Gjelbëruese
në Pejë





Hapësirat Publike Gjelbëruese në Pejë

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Hapësirat Publike Gjelbëruese në Pejë" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.





Hyrje

Me hapësira publike të gjelbra i referohemi hapësirave të cilat janë të dizajnuara për të qenë të qasshme dhe të shfrytëzueshme për të gjithë. Ato duhet të jenë të pasura me vegjetacion, ndriçim publik dhe mobiluar urban si ulëse, shporta, kënde të lojërave për fëmijë, etj. Këto hapësira ofrojnë një sërë përfitimesh për individët dhe komunitetin, duke përfshirë përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor, rritjen e kohezionit social dhe rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore.

Hapësirat publike të gjelbra janë thelbësore për krijimin e qyteteve të shëndetshme dhe të jetueshme, pasi ato ofrojnë mundësi për rekreacion, relaksim dhe ndërveprim social. Ato gjithashtu ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike duke reduktuar ishujt e nxehtësisë, duke përmirësuar cilësinë e ajrit, etj. Përveç kësaj, hapësirat publike të gjelbra mund të ofrojnë habitat për jetën e egër, të mbështesin biodiversitetin dhe të rrisin cilësinë e përgjithshme estetike të zonave urbane.

Projektimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike të gjelbra kërkon shqyrtim të kujdesshëm të faktorëve të tillë si përzgjedhja e vendndodhjes, përzgjedhja e bimëve, ujitja dhe kullimi, dhe angazhimi i komunitetit. Kur janë të dizajnuara dhe të mirëmbajtura mirë, hapësirat publike të gjelbra mund të ofrojnë një gamë të gjerë përfitimesh për individët dhe komunitetet, duke kontribuar në shëndetin e përgjithshëm dhe qëndrueshmërinë e mjedisve urbane.

Sipas UN Habitatit hapësirat publike janë përbërësit vital për qytetet e suksesshme. Ato ndihmojnë në ndërtimin e komunitetit, identitetit qytetar dhe kulturës. Hapësirat publike lehtësojnë kapitalin social, zhvillimin ekonomik dhe rivitalizimin e komunitetit. Përdorimi i vazhdueshëm i hapësirave publike si e mirë publike çon kah mjediset urbane që janë të mirëmbajtura mirë, të shëndetshme dhe të sigurt, duke e bërë qytetin vend atraktiv për jetesë dhe punë.¹


Pra, hapësirat publike paraqesin elementin bazë të një qyteti funksional, por për fat të keq në Kosovë këto hapësira përveçse nuk janë të mjaftueshme ato nuk janë edhe gjithëpërfshirëse. Përfshirja e banorëve në projektimin, planifikimin dhe administrimin e hapësirave publike është thelbësore për të ruajtur cilësinë e këtyre hapësirave. Përfshirja e banorëve (përfshirë këtu edhe përfaqësimin gjinor të barabartë) siguron që natyra dhe përdorimi i hapësirës publike të përmbushin nevojat e veçanta të komunitetit. Nëse një hapësirë nuk pasqyron kërkesat dhe dëshirat e popullsisë lokale, ajo nuk do të përdoret ose mirëmbahet. Pjesëmarrja sociale është një element qendror për ndërtimin e zonave publike të sigurt dhe të barabarta.²

Andaj, EC Ma Ndryshe pas qytetit të Prizrenit, Gjakovës dhe Ferizajt ka realizuar këtë hulumtim edhe me qytetarët e Pejës me qëllimin që të merret një vlerësim direkt nga ana e tyre mbi gjendjen dhe kualitetin e hapësirave publike, se sa janë të qasshme dhe të shfrytëzueshme për të gjithë, dhe se a janë të mjaftueshme këto hapësira për ta. Në këtë hulumtim janë anketuar gjithsejtë 159 qytetar prej të cilëve 96 ishin gra dhe 63 ishin burra.


¹ <https://unhabitat.org/global-public-space-toolkit-from-global-principles-to-local-policies-and-practice> (qasur më: 22 mars 2023)

² https://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152201_Hulumtimi_Hap_sirat_Publike_2017_1.pdf (qasur më: 22 mars 2023)

Sa shpesh i frekuentoni parqet publike?




A mendoni se ka mjaftueshëm hapësira publike të gjelbëruara në qytet?




A janë të mjaftueshme dhe të mirëmbajtura ulëset nëpër parqe dhe hapësira publike?




A mendoni se ka mjaftueshëm shporta dhe konteiner për mbeturina në parqet dhe hapësirat publike dhe a mirëmbahen nga institucionet përgjegjëse?




A ka kënd të lojërave për fëmijë në parkun e lagjes tuaj?




Sa mendoni se ka nevojë qyteti i Pejës për shtigje të biçikletave?




A mendoni se krijimi i shtigjeve/rrugëve për biçikleta dhe parkingjeve për biçikleta nëpër qytet do ta shtonte përdorimin e biçikletave si mjet transportues?




A mendoni se arti publik ndihmon në rritjen e shfrytëzueshmërisë së hapësirave publike (murale, vizatime...)?




A mendoni se lagjja juaj ka hapësira potenciale për zhvillimin e artit publik (murale, vizatime...)?




A kujdesen banorët e lagjes për mirëmbajtjen e parkut dhe hapësirave publike?




A mendoni se ndriçimi në parqe dhe hapësira publike është i mjaftueshëm?




A mendoni se parqet dhe hapësirat publike janë të sigurta për vajzat/gratë?



A janë të qasshme parqet dhe hapësirat publike për personat me aftësi të kufizuara?



A ekziston rreziku nga qentë endacak në parkun e lagjes dhe hapësirat publike?



A jeni ftuar ndonjëherë nga institucionet komunale për të diskutuar dhe ofruar propozime rreth hapësirave gjelbëruese në qytet?



Gjetjet e hulumtimit

- Sipas rezultateve të nxjerra nga ky hulumtim, parqet publike në qytetin e Pejës frekuentohen rregullisht nga 12% e qytetarëve, shpesh nga 43%, rrallë nga 43% të tjerë dhe asnjëherë nga 2% e tyre.
- 159 qytetarë janë pyetur se a ka mjaftueshëm hapësira publike të gjelbëruara në qytetin e Pejës, prej të cilëve 16% janë shprehur me “Po”, 42% e tyre kanë thënë “Deri diku”, 30% të tjerë kanë thënë se “Ka nevojë për më shumë” dhe vetëm 12% e qytetarëve mendojnë se “Jo” nuk ka mjaftueshëm hapësira publike të gjelbëruara.
- Në vazhdim , 58% e qytetarëve të anketuar kanë treguar se ulëset nëpër parqe dhe hapësira publike janë të mjaftueshme por nuk mirëmbahen dhe janë të dëmtuara, 32% të tjerë potencojnë se ato nuk janë të mjaftueshme dhe nuk mirëmbahen, ndërsa vetëm 10% pohojnë se ulëset janë të mjaftueshme dhe janë në nivelin e duhur.
- Lagjet të cilat qytetarët kanë sugjeruar se kanë nevojë më shumë ndërtimin e hapësirave të reja dhe rregullimin e atyre ekzistuese të cilat kanë nevojë të shtohet gjelbërim apo të ndërtohet ndonjë park janë: Dardania, Fidanishtja, Qendra e qytetit, Puhovci, Jarina dhe Haxhi Zeka.
- 66% e qytetarëve mendojnë se “Jo” nuk ka mjaftueshëm shporta dhe kontejnerë për mbeturina në parqet dhe hapësirat publike dhe se ato nuk mirëmbahen nga institucionet përgjegjëse. 21% të tjerë kanë shprehur se po ka mjaftueshëm shporta dhe kontejnerë për mbeturina në parqet dhe hapësirat publike por nuk mirëmbahen nga institucionet përgjegjëse, ndërsa vetëm 13% prej tyre theksojnë se ka mjaftueshëm dhe se mirëmbajtja e tyre realizohet nga institucionet përgjegjëse.
- Sipas 59% e qytetarëve në parqet e lagjeve të Pejës mungojnë këndet e lojërave për fëmijë, ndërsa 28% e qytetarëve kanë thënë se ka kënde të lojërave por ato janë të dëmtuara dhe vetëm 13% e qytetarëve kanë treguar se në lagjen e tyre ka kënd të lojërave dhe është në gjendje të mirë.
- Sa i përket shtigjeve të biçikletave, 85% e qytetarëve të anketuar kanë thënë se qyteti i Pejës ka shumë nevojë për shtigje të biçikletave, 14% kanë thënë se ka mesatarisht nevojë për shtigje pasi që në Pejë ekzistojnë disa hapësira të dedikuara për shfrytëzim të biçikletave, ndërsa vetëm 1% e qytetarëve kanë theksuar se nuk ka aspak nevojë për shtigje pasi Peja ka mjaftueshëm shtigje për biçikleta.
- 66% e qytetarëve mendojnë se krijimi i shtigjeve/rrugëve për biçikleta dhe parkingjeve për biçikleta nëpër qytet do ta shtonte shumë përdorimin e biçikletave si mjet transportues, 32% të tjerë kanë thënë se kjo do ndikoj mesatarisht, ndërsa 2% kanë thënë se krijimi i tyre nuk do ndikoj aspak.

- Arti publik është një element tjetër me shumë rëndësi që ndikon në rritjen e shfrytëzueshmërisë së hapësirave publike duke i bërë ato më atraktive për qytetarët. E kështu, 60% e qytetarëve të Pejës pajtohen plotësisht me këtë fakt se arti publik ndihmon në rritjen e shfrytëzueshmërisë së hapësirave publike (murale, vizatime...), 33% pajtohen pjesërisht dhe vetëm 7% nuk pajtohen aspak me këtë fakt.
- Po ashtu, 31% e qytetarëve kanë treguar se lagjja e tyre ka hapësira potenciale për zhvillimin e artit publik, 45% po ashtu kanë theksuar se lagjja tyre ka hapësira potenciale por ato sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe pjesa tjetër e qytetarëve (25%) mendojnë se lagjet e tyre nuk kanë hapësira potenciale për zhvillimin e artit publik.
- Sa i përket mirëmbajtjes së këtyre hapësirave nga ana banorëve, 60% e të anketuarve kanë thënë se banorët e lagjeve ndonjëherë kujdesen dhe mirëmbajnë këto hapësira, 23% të tjerë kanë pohuar se banorët janë të kujdesshëm dhe i mirëmbajnë ato, ndërsa vetëm 21% e kanë mohuar këtë fakt.
- Ndriçimi publik në parqet dhe hapësirat publike në qytetin e Pejës sipas 56% e qytetarëve është deri diku i mjaftueshëm, 23% e tyre nuk e konsiderojnë të mjaftueshëm dhe vetëm 21% e tyre mendojnë se ndriçimi publik është i mjaftueshëm.
- Parqet dhe hapësirat publike në Pejë konsiderohen të sigurta për vajzat dhe gratë nga 12% e qytetarëve, deri diku të sigurta nga 45% e tyre dhe si jo të sigurta shihen nga 43% qytetarëve të tjerë.
- Nga 43% e qytetarëve këto hapësira konsiderohen si qasshme nga PAK vetëm me përcjellje, 46% të tjerë i konsiderojnë pjesërisht të qasshme dhe vetëm nga 13% e qytetarëve mendojnë se këto hapësira janë të qasshme për PAK.
- Këto hapësira qytetarët i konsiderojnë me rrezik edhe nga prania e qenëve endacak, ku 97% e tyre kanë shprehur se ekziston rreziku nga qentë dhe vetëm 3% e tyre nuk e shohin si rrezik këtë pjesë.
- Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikimin e këtyre hapësirave është një element kyç për zgjidhjen apo parandalimin e të gjitha problemeve të lartpërmendura, andaj qytetarët janë pyetur se a janë ftuar ndonjëherë nga institucionet komunale për të diskutuar dhe ofruar propozime rreth hapësirave gjelbëruese në qytet, në këtë rast 86% e tyre kanë treguar se nuk janë ftuar në diskutime të tilla, 12% kanë thënë se janë ftuar por nuk kanë marrë pjesë dhe vetëm 3% e tyre janë ftuar dhe kanë marrë pjesë.

Përfundime dhe Rekomandime:

Bazuar në rezultatet e dala nga ky hulumtim, hapësirat publike të gjelbra në qytetin e Pejës kanë mangësi të theksuara, duke filluar që nga mobiliari urban, ndriçimi publik, mungesa e shtigjeve dhe parkingjeve për biçikleta, mungesa e këndeve të lojërave për fëmijë, etj. Sipas qytetarëve në Pejë ka hapësira ekzistuese të cilat janë të shfrytëzueshme, por që kanë nevojë të mirëmbahen dhe të investohet nga ana e institucioneve përgjegjëse, e në të njëjtën kohë ata kanë shprehur edhe kërkesën për shtimin e këtyre hapësirave duke iniciuar gjithëpërfshirjen e tyre që nga hapat e parë të planifikimit të këtyre hapësirave.

Pra, parqet në qytetin e Pejës nuk janë në nivelin e duhur dhe se ka shumë nevojë për marrje të masave konkrete në drejtim të zgjidhjes së problemeve që janë evidentuar nga vet qytetarët.

Menaxhimi i hapësirave publike përfshinë nevojën për koordinimin e intervenimeve në këto hapësira, rregullimin e përdorimit të tyre, pastaj përcaktimin e rutinave të mirëmbajtjes dhe definimin e investimeve dhe shërbimeve.

- Duke pasur parasysh problematikat e lartpërmendura për të pasur sa më shumë hapësira të gjelbra të shfrytëzueshme nga të gjithë, komuna e Pejës duhet të fokusohet në veçanti në zbatimin e hapave të përgjithshëm për të siguruar një qytet pa barriera për të gjithë qytetarët, sidomos për PAK. Në të njëjtën kohë duhet të punojnë shumë në drejtim të krijimit të ndjenjës së sigurisë tek qytetarët gjatë shfrytëzimit të këtyre hapësirave nga qytetarët, në veçanti për vajzat dhe gratë. Si dhe duhet të fokusohen në trajtimin e qenëve endacak pasi që nga shumica e qytetarëve ky problem shihet si rrezik për ta.
- Shtimi i mobiliarit urban, ndriçimit publik, shtigjeve dhe parkingjeve për biçikleta, artit publik janë me shumë rëndësi të realizohen apo intervenohen në hapësira publike nga ana e institucioneve përgjegjëse. Andaj EC rekomandon që këto institucione të krijojnë në plan të mobilitetit përmes të cilit të gjitha këto elemente do të mund të përfshihen në këto hapësira.
- Elementi më me rëndësi sipas EC është gjithëpërfshirja e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje, andaj dhe rekomandon që këto institucione të vazhdojnë mbajtjen e konsultimeve publike me qytetarët e komunës së Pejës, duke organizuar takime dhe diskutime direkte mes tyre dhe ekspertëve të ndryshëm në mënyrë që këto hapësira të ndërtohen duke u bazuar direkt në kërkesat e tyre.

Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijën. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e komprometuar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.